



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE

Nr. 611/33 Prot.
Vlorë më 05/10/2022.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALBANIAN UNIVERSITY", TIRANË

Nr. 547 Prot.
Tiranë më 29/09/2022.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Nisur nga interesi i përbashkët në zhvillimin e mësimdhënies dhe të kërkimit në të dy universitetet dhe nga përpjekjet për të zgjeruar kontaktet midis universiteteve;

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, përfaqësuar nga Prof. Dr. Roland ZISI, Rektor, më poshtë do të njihet si pala 1, është një institucion publik, që ka statusin juridik, krijuar në pajtim me nenin 57, paragrafi 7 i Kushtetutës së Shqipërisë dhe të ligjit 80/2015 «Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë»;

Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë ka kompetencë për të marrë pjesë në shërbimet publike në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, dhe krijimin e marrëdhënieve me institucionet e tjera akademike, kulturore dhe shkencore, qofshin Shqiptarë apo nga vendet të tjera;

"Albanian University" përfaqësuar nga Prof. Dr. Pavlo KONGO, Rektor, më poshtë do të njihet si pala 2 është një institucion privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë. Licencuar në Prill të vitit 2004, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

Bien dakord për të nënshkruar një Marrëveshje Bashkëpunimi të bazuar në klauzolat në vijim:

NENI 1 BAZA LIGJORE

Universitetet përcaktojnë dhe rregullojnë me këtë marrëveshje hapësirat dhe çështjet e bashkëpunimit të ndërsjellët, si dhe format dhe mënyrat e zbatimit të saj.

NENI 2 QËLLIMI I MARRËVEASHJES

Bashkëpunimi do të ndërmerret duke pasur si subjekt disponueshmërinë e fondeve dhe miratimin e Universiteteve përmes aktiviteteve të tilla ose programeve të cilat kanë të bëjnë me:

1. Ndarja e praktikave më të mira, përmirësimi i formave dhe metodave të organizimit të procesit të mësimdhënies, prezantimi me teknologjitë e fundit në procesin mësimor;
2. Kryerja e analizave të përbashkëta të materialeve (shkencore, metodologjike, tekstet shkollore, ndihmat edukative, kurset, ligjëratat, etj.) në formë të shkruar dhe elektronike;
3. Shkëmbimin e botimeve dhe literaturave shkencore të reja midis bibliotekave;



4. Ftohen lektorë nga fakultete të kualifikuara për mbajtjen e leksioneve në lidhje me fusha të ndryshme të shkencës, organizimin e seminareve të përbashkëta për përmirësimin e kualifikimit të personelit deri në 15 persona në një vit;
5. Shkëmbimi i informacionit mbi hulumtime, konferenca shkencore dhe simpoziume për të mundësuar pjesëmarrjen në aktivitete të ngjashme;
6. Zhvillimi i kërkimeve të përbashkëta shkencore, shkëmbimi i rezultateve të hulumtimit me qëllim kryerjen e konsultimeve shkencore, seminareve, kërkimeve etj;
7. Shkëmbim eksperience në përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të institucionit me përdorimin e teknologjive të informacionit;
8. Mbajtjen e seminareve të përbashkëta në lidhje me përmirësimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë në institucion;
9. Organizimi i shkëmbimit të studentëve midis dy institucioneve (deri në 30 studentë në vit);
10. Zhvillimin e programeve të përbashkëta;
11. Ofrim i programeve të përbashkëta nga Fakultetet/Departamentet përkatëse;
12. Zhvillimin e programeve të veçanta akademike afatshkurtra;
13. Krijimin e fushave të tjera në të cilat është krijuar ose do të zhvillohet interesi i përbashkët reciprok për bashkëpunim.

NENI 3 TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Në bazë të kësaj marrëveshjeje, anëtarët e Universiteteve do të përcaktojnë tipin, qëllimin dhe parimet e realizimit të kësaj marrëveshjeje në një aneks të veçantë të saj.
(Shënim: Të përcaktohen të detajuara detyrimet e palëve, konkretisht numrat e kualifikimit të personelit, numrat e studentëve)

NENI 4 MËNYRA E REALIZIMIT

Secili Universitet do të caktojë një person ndërlidhës i cili do të jetë përgjegjës për të koordinuar dhe zhvilluar realizimin e aktiviteteve ose të programeve specifike.

NENI 5 FONDI I AKTIVITETEVE

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje varet nga disponueshmëria e fondeve për aktivitetet e përbashkëta. Të gjitha angazhimet, detyrimet dhe shpenzimet në lidhje me projektet e aprovuara nën këtë marrëveshje do të administrohen në përputhje me çdo praktikë dhe politikë normale si dhe në përputhje me termat dhe kushtet e agjencive të fondeve për çdo universitet.

NENI 6 PËRGJEGJËSITË E PALËVE

Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje Universitetet nuk nënkuptojnë asnjë detyrim financiar.

Neni 7 AMENDAMENTET

Amendamente të mundshme ose shtesa të kësaj marrëveshjeje do të formulohen dhe parashirohen me shkrim dhe do të jenë pjesë e një aneksi të marrëveshjes.

NENI 8 SHKAQET MADHORE



Universitetet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjes të punës, çrregullimeve civile, motit të keq, fuqive Madhore ose shkaqeve të tjera të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t'i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse Universitetet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e marrëveshjes.

NENI 9 AFATI / HYRJA NË FUQI E KONTRATËS

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

Kjo kontratë lidhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data _____ deri në datë _____, me të drejtë ripërteritje.

Me kalimin e 10 ditëve nga data e përfundimit të afatit të kontratës, nëse palët nuk shprehen me shkrim, kontrata konsiderohet e rinovuar.

Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim për një afat 3 vjeçar.

NENI 10 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJES

1. Për gjithcka që nuk është shprehur posacërisht, i referohet legjislacionit civil në fuqi;
2. Kjo marrëveshje mund të zgjidhet me një kërkesë me shkrim nga njëra palë, drejtuar palës tjetër brenda afatit 6 (gjashtë) mujor, ose (180 dite)
3. Mosmarrëveshjet e lindura midis palëve zgjidhen me mirëkuptim. Për çdo mosmarrëveshje, palët i drejtohen me shkrim njera-tjetrës;
4. Në rast se mosmarrëveshjet e lindura mes palëve, gjatë zbatimit të kësaj kontrate nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, palët kane te drejte t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Kjo akt-marrëveshje është formuluar në 4 (katër) kopje origjinale, e cila u lexua nga palët, u kuptua, pranua dhe nënshkrua me vullnet të plotë e të lirë.

Vlorë më, 03.10.2021

Prof. Dr. Roland ZISI
Rektor
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë



Tiranë më,

Prof. Dr. Pavllo Kongo
Rektor
"Albanian University" Tiranë

